



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 23

Tiranë – E premte, 11 shkurt 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 6, datë 3.2.2022	Për zgjedhjen e zotit Gent Sejko anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë..... 2725
Vendim i Kuvendit nr. 7, datë 3.2.2022	Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për përpunimin e materialeve zgjedhore, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve..... 2725
Vendim i Kuvendit nr. 8, datë 3.2.2022	Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2726
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 81, datë 9.2.2022	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme..... 2728
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 82, datë 9.2.2022	Për disa shtesa në vendimin nr. 523, datë 22.9.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”..... 2729
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 94, datë 9.2.2022	Për miratimin e rregullave të detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore, që regjistrohen në Regjistrin Elektronik të Organizatave Jofitimprurëse, për dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, si dhe për nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara..... 2730
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 96, datë 9.2.2022	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i parkimit publik, lulishte e ndriçim”, Bashkia Cërrik..... 2733
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 98, datë 9.2.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar..... 2735

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 9.2.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 146, datë 10.3.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Muzeut të Arsimit Korçë”	2736
	Vendim i shkurtuar për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Besjana Zeneli.....	2736
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetases Alma Mustafaj.....	2736

**VENDIM
Nr. 6/2022****PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT GENT
SEJKO ANËTAR I KËSHILLIT
MBIKËQYRËS TË BANKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të nenit 44, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Gent Sejko zgjidhet anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 3.2.2022.

**VENDIM
Nr. 7/2022****PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS,
ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT
TË PAGAVE TË PERSONELIT ME
KOHË JO TË PLOTË PUNE,
QË REKRUTOHET PËR PËRPUNIMIN
E MATERIALEVE ZGJEDHORE,
TË KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të shkronjës “m”, të nenit 19, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për përpunimin e materialeve zgjedhore, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

II. Struktura, organika dhe klasifikimi i pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për përpunimin e materialeve zgjedhore, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 3.2.2022.



Lidhja nr. 1

Struktura, organika	Pozicionet e punës	Numri i punonjësve	Periudha e punësimit	Kategoria e pagës	Kriteret e punësimit
Drejtoria e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore					
Sektori i Materialeve Zgjedhore	Specialist	13	2 muaj	IV-b	Arsim i lartë/të ketë eksperiencë pune në logjistikën zgjedhore.
	Specialist	2	3 muaj		
	Punëtor	45	2 muaj	III	Arsim i detyruar.
Drejtoria e Burimeve Njerëzore					
Sektori i Administrimit dhe Arkivimit të Dokumentacionit	Operator	5	2 muaj	V	Arsim i detyruar.
TOTAL		65			

VENDIM
Nr. 8/2022

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS,
ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT
TË PAGAVE TË PERSONELIT ME
KOHË JO TË PLOTË PUNE,
QË REKRUTOHET PËR ZHVILLIMIN E
ZGJEDHJEVE TË PJESSHME,
TË KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të shkronjës “m”, të nenit 19, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

I. Miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

II. Struktura, organika dhe klasifikimi i pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratur në datën 3.2.2022.



Lidhja nr. 1

Struktura, organika	Pozicione pune	Numri i punonjësve	Periudha e punësimit	Kategoria e pagës	Kriteret e punësimit
Zëdhënës	Specialist	2	2 muaj	IV-b	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
1. Drejtoria e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore					
Sektori i Materialeve Zgjedhore	Specialist	6	2 muaj	IV-b	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
	Specialist për vulat	2	2 muaj		Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
	Operator	1	2 muaj	V	Arsim i detyruar.
	Punëtor	30	2 muaj	III	Arsim i detyruar.
	Punonjës pastrimi	2	2 muaj	I	Arsim i detyruar.
Sektori i Trajnimeve	Specialist disegn	1	2 muaj	IV-b	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
	Operator	1	2 muaj	V	Arsim i detyruar.
Sektori i Mbikëqyrjes dhe Koordinimit	Specialist	1	2 muaj	IV-b	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
	Operator	1	2 muaj	V	Arsim i detyruar.
2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore					
Sektori i Administrimit dhe Arkivimit të Dokumentacionit	Specialist	3	2 muaj	IV-b	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
	Operator	2	2 muaj	V	Arsim i detyruar.
	Fotokopjues/Postier	1	2 muaj	II	Arsim i detyruar.
	Magaznier	1	2 muaj	VI	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
Sektori i Shërbimeve	Receptionist	1	2 muaj	III	Arsim i detyruar.
3. Drejtoria Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor					
Sektori i Përgatitjeve të Akteve	Specialistë	4	2 muaj	IV-b	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
Sektori i Verifikimit të Dokumenteve dhe Këshillimit Ligjor mbi Ankesat Administrative dhe Gjyqësore	Specialistë	2	2 muaj	IV-b	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
4. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës					
	Specialist	2	2 muaj	IV-b	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
5. Drejtoria e Komunikimit					
Sektori i Programeve të Edukimit të Zgjedhësve	Specialist	5	2 muaj	IV-b	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.



Sektori i Vëzhgimit dhe Koordinimit Ndërkombëtar	Specialist	2	2 muaj	IV-b	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
6. Drejtoria e Administrimit të të Dhënave dhe Sistemeve IT					
Sektori i Administrimit të të Dhënave dhe Sistemeve	Specialist PENV	2	2 muaj	IV-b	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
	Specialist	15	2 muaj	IV-b	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
	Operatorë	7	2 muaj	V	Arsim i detyruar.
	Specialist koordinator	4	3 muaj	IV-b	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
	Specialist teknik	16	3 muaj	IV-b	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
	Specialist logjistike dhe koordinimi në terren	4	2 muaj	IV-b	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
	Specialist teknik	3	3 muaj	IV-b	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
	Specialist mbikëqyrës operatorësh	8	3 muaj	IV-b	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
	Specialist trajnimi & suporti	20	1 muaj	IV-b	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
	Specialist trajnimi	2	3 muaj	IV-b	Arsim i lartë/master profesional/shkencor.
7. Drejtoria e Kontrollit Financiar dhe Auditit të Brendshëm					
Sektori i Kontrollit Financiar	Specialist	1	2 muaj	IV-b	Arsim i lartë.
TOTAL		152			

VENDIM**Nr. 81, datë 9.2.2022**

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË
PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Misioni i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme është hartimi dhe zbatimi i politikave të jashtme, drejtimi teknik dhe bashkërendimi i procesit të integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, zhvillimi dhe fuqizimi i diplomacisë ekonomike, si dhe mbrojtja e të drejtave të shtetasve shqiptarë dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit.



3. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) Harton, përpunon, organizon dhe zbaton politikën e jashtme të shtetit shqiptar;

b) Realizon shprehjen dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar dhe të shqiptarëve në marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare;

c) Mbështet Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Këshillin e Ministrave dhe Presidentin e Republikës së Shqipërisë në përcaktimin e qëndrimeve të rëndësishme lidhur me politikën e jashtme;

ç) Mbron të drejtat e shtetasve shqiptarë dhe të komuniteteve shqiptare jashtë vendit, si dhe organizon, harton e zbaton politikën shtetërore në interes të tyre në bashkëpunimin me ministrinë përgjegjëse;

d) Nxit dhe ndihmon për zhvillimin e komunikimit e të ndërveprimit të diasporës dhe të shqiptarëve jashtë kufijve me përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë, në shtetet ku ata banojnë;

dh) Promovon dhe ndihmon në rritjen e zhvillimin e vlerave dhe të traditave më të mira shqiptare të bashkëkombësit jashtë kufijve shtetërorë;

e) Promovon interesin ekonomik kombëtar në arenën ndërkombëtare, duke ndërmarrë aktivitete zyrtare diplomatike të fokusuar në rritjen e eksporteve, tërheqjen e investimeve të huaja dhe pjesëmarrjen në punë të organizatave ekonomike ndërkombëtare;

ë) Bashkërendon procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nëpërmjet përafrimit të legjislacionit dhe hartimit të politikave të integritetit, si dhe propozon projektaktet, që kanë lidhje me procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

4. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 500, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, dhe nr. 510, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Diasporën”, shfuqizohen.

5. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 82, datë 9.2.2022

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 523, DATË 22.9.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 523, datë 22.9.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

a) Në fund të pikës 2 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Ministria e Arsimit dhe Sportit nxit, drejton dhe është përgjegjëse për procesin e botimeve shkollore e kërkimore-shkencore, si dhe të teksteve të veçanta, të cilat i shërbejnë diasporës.”.

b) Në pikën 3, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) Botimi për diasporën.”

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 94, datë 9.2.2022

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
DETAJUARA PËR TË DHËNAT
PARËSORE DHE DYTËSORE, QË
REGJISTROHEN NË REGJISTRIN
ELEKTRONIK TË ORGANIZATAVE
JOFITIMPRURËSE, PËR DHËNËSIT E
INFORMACIONIT, NDËRVEPRIMIN
ME BAZAT E TJERA TË TË DHËNAVE,
SI DHE PËR NIVELIN E AKSESIMIT
PËR SUBJEKTET E INTERESUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 80/2021, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka si objekt përcaktimin e rregullave të detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore, që regjistrohen në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse, për dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, si dhe për nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse.

2. Regjistri elektronik i organizatave jofitimprurëse është një bazë e të dhënave shtetërore, nëpërmjet së cilës grumbullohet informacioni i organizuar dhe i ruajtur në formë elektronike për organizatat jofitimprurëse, ku përpunimi e përditësimi i tij kryhen përmes një sistemi kompjuterik.

3. Regjistri elektronik i organizatave jofitimprurëse krijohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe administrohet e mirëmbahet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me parimet, kriteret e masat tekniko-organizative të zbatueshme për garantimin dhe menaxhimin e sigurisë në përpunimin e të dhënave personale, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Në këtë projektvendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Të dhëna”, faktet, aktet e informacionet që regjistrohen, njoftohen apo depozitohen në regjistrë;

b) “Gjykata”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

II. PËRMBAJTJA, ADMINISTRIMI DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE TË REGJISTRIT ELEKTRONIK TË ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

5. Regjistri elektronik i organizatave jofitimprurëse përmban të dhëna, që lidhen me themelimin, fushën e veprimtarisë dhe çregjistrimin e organizatave jofitimprurëse, çdo ndryshim në status dhe formën e organizimit të tyre, të dhëna që i përkasin atyre lidhur me përfaqësimin, si dhe të dhëna të tjera të parashikuara me ligj.

6. Regjistri elektronik i organizatave jofitimprurëse përmban të dhëna, si më poshtë vijon:

a) Për regjistrimin fillestar të organizatave jofitimprurëse janë të detyrueshme këto të dhëna:

i. emri;

ii. forma e organizimit;

iii. data e themelimit;

iv. të dhënat e identifikimit të themeluesve, duke dhënë në çdo rast emrin, mbiemrin, vendlindjen, datëlindjen, adresën e vendbanimit, numrin e identitetit, si dhe të dhënat elektronike të kontaktit të tyre. Në rastet kur themeluesi është person juridik, të dhënat e detyrueshme për t’u regjistruar janë emri i personit juridik, forma juridike, numri unik i identifikimit, data e themelimit dhe e regjistrimit, selia, emri i përfaqësuesit ligjor të subjektit apo personave përgjegjës për përfaqësimin e subjektit në marrëdhënie me të tretët, si dhe të dhënat elektronike të kontaktit të tyre;

v. selia;

vi. qëllimi dhe fusha e veprimtarisë;

vii. kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar;

viii. anëtarët e organeve drejtuese, duke dhënë në çdo rast emrin, mbiemrin, vendlindjen, datëlindjen e tyre, numrin e identitetit, si dhe të dhënat elektronike të kontaktit të tyre;

ix. të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e organizatës jofitimprurëse në marrëdhënie me të tretët, duke dhënë në çdo rast emrin, mbiemrin, vendlindjen, datëlindjen, adresën e vendbanimit,



numrin e identitetit, si dhe të dhënat elektronike të kontaktit të tyre, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre;

x. në rastin e fondacionit, përbërja dhe vlera pasurore e fondit themelues;

xi. specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë organizatën jofitimprurëse përpara të tretëve.

b) Për regjistrimin fillestar të degëve të organizatave jofitimprurëse të huaja janë të detyrueshme këto të dhëna:

i. emri i organizatës jofitimprurëse të huaj;

ii. forma e organizimit të organizatës jofitimprurëse të huaj;

iii. data e themelimit të organizatës jofitimprurëse të huaj;

iv. selia e organizatës jofitimprurëse të huaj;

v. qëllimi dhe fusha e veprimtarisë së organizatës jofitimprurëse të huaj;

vi. kohëzgjatja e organizatës jofitimprurëse të huaj, në qoftë se është e përcaktuar;

vii. të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e organizatës jofitimprurëse të huaj në marrëdhënie me të tretët, duke dhënë në çdo rast emrin, mbiemrin, vendlindjen, datëlindjen, adresën e vendbanimit, numrin e identitetit, si dhe të dhënat elektronike të kontaktit të tyre, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre;

viii. në rastin e fondacionit të huaj, përbërja dhe vlera pasurore e fondit themelues;

ix. numri dhe vendi i regjistrimit të organizatës jofitimprurëse të huaj;

x. vendimi i organit kompetent për hapjen e degës, dokumente dhe akte të tjera shoqëruese të detyrueshme për njoftim apo regjistrim, sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse;

xi. emri i degës, nëse është i ndryshëm nga ai i organizatës jofitimprurëse të huaj;

xii. kohëzgjatja e degës, në qoftë se kjo është e përcaktuar;

xiii. qëllimi dhe fusha e veprimtarisë së degës;

xiv. selia e degës;

xv. të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e degës në marrëdhënie me të tretët, përfshirë dhe aktin për caktimin ose emërimin e përfaqësuesit ligjor të degës së organizatës së huaj, kompetencat e përfaqësimit e afatet e emërimit;

xvi. specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë degën në marrëdhënie me të tretët.

7. Regjistri elektronik i organizatave jofitimprurëse përmban gjithashtu informacione dhe dokumente, si më poshtë vijon:

a) pasqyra financiare vjetore, të mbajtura sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme;

b) emërimi i likuidatorit, si dhe të dhënat e tij të identifikimit;

c) akte të prishjes, të mbylljes apo të shpërndarjes, akte të transformimit, të bashkimit, të ndarjes, hapjes së procedurave të administrimit, likuidimit ose riorganizimit, si dhe aktet e tjera të ndërmjetme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Për degët e organizatave jofitimprurëse të huaja regjistrohen edhe aktet e transformimit, të bashkimit, të ndarjes, të hapjes e të mbylljes së procedurave të likuidimit ose të falimentimit të organizatës jofitimprurëse të huaj;

ç) vende të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia;

d) kompetenca të përfaqësimit të organeve drejtuese ose të likuidatorëve;

dh) emra, mbiemra, datëlindje dhe vlera të kontributeve pasurore të fondit themelues (nëse ka të tilla);

e) çdo regjistrim tjetër të detyrueshëm, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

8. Regjistri elektronik i organizatave jofitimprurëse përmban edhe të dhëna shtesë (vullnetare), të cilat përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

a) emërtimin ose shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë (nëse është/janë i/të ndryshëm/me nga emri i regjistruar i organizatës jofitimprurëse);

b) faqen e internetit, *email*-in, numrin e telefonit dhe të faksit;

c) vendimet e organeve drejtuese të organizatës jofitimprurëse, si vendimet e pezullimit të veprimtarisë apo vendimet e tjera, të ndryshme nga vendimet e detyrueshme për regjistrim;

ç) të dhëna të tjera, të lidhura me veprimtarinë e organizatës jofitimprurëse.

9. Të dhënat që përmban regjistri elektronik i organizatave jofitimprurëse ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:



a) Të dhëna parësore janë:

- i. të dhënat e themelimit e të fushës së veprimtarisë së organizatave jofitimprurëse;
- ii. të dhënat e identifikimit, si: forma, emri, numri e vendi i regjistrimit dhe selia;
- iii. të dhënat që lidhen me formën e organizimit të organizatës jofitimprurëse;
- iv. të dhënat e vendimit të gjykatës për regjistrimin e organizatës jofitimprurëse;
- v. në rastin e fondacionit e të qendrës, përbërja dhe vlera pasurore e fondit themelues;
- vi. çdo ndryshim në status dhe formën e organizimit të organizatës jofitimprurëse;
- vii. të dhënat e çregjistrimit të organizatës jofitimprurëse;
- viii. të dhënat për dokumentet shoqëruese/akte dhe informacione që regjistrohen, njoftohen apo depozitohen në regjistrë;
- ix. të dhënat për organizatat jofitimprurëse të huaja, që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- x. kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimit të personave përgjegjës për administrimin e përfaqësimit të organizatës në marrëdhënie me të tretët.

b) Të dhënat dytësore janë:

- i. të dhënat referenciale të gjendjes civile, si: numri personal i identifikimit, emri, mbiemri, atësia, vendlindja, datëlindja, gjinia, bashkia, adresa;
- ii. të dhënat referenciale, si: përfaqësuesi, roli i përfaqësuesit, emri i subjektit, tipi i subjektit, NUIS-i, bashkia, adresa, shteti;
- iii. të dhënat referenciale nga ndërveprimi me baza të dhënash të tjera, sipas pikës 10, të këtij vendimi.

III. NDËRVEPRIMI ME BAZAT E TJERA TË TË DHËNAVE DHE NIVELI I AKSESIMIT PËR SUBJEKTET E INTERESUARA

10. Baza e të dhënave të regjistrimit elektronik të organizatave jofitimprurëse ndërvepron me baza të tjera të dhënash, si më poshtë vijon:

- a) të dhëna nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- b) të dhëna nga Regjistri Tregtar, i administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
- c) të dhëna nga baza e të dhënave “Tatimi elektronik”, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, dhe të dhëna nga baza e

të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore;

ç) të dhëna nga Regjistri Noterial Shqiptar, lidhur me organizatat jofitimprurëse të krijuara me akt testamentar;

d) të dhëna nga sistemi elektronik për menaxhimin e kontributeve, administruar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

11. Dhënës të informacionit janë:

- a) gjykata;
- b) subjektet themeluese të organizatave jofitimprurëse;
- c) organizatat jofitimprurëse;
- ç) autoritetet publike/private që kanë detyrimin në bazë të ligjeve të posaçme.

12. Subjekte të interesuara janë:

- a) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- b) prokuroria, Policia e Shtetit apo organe të tjera të hetimit;
- c) çdo subjekt tjetër i përcaktuar shprehimisht me vendim të Këshillit të Ministrave;
- ç) çdo person i interesuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

13. Niveli i aksesit në sistemin dhe bazën e të dhënave të regjistrimit elektronik është, si më poshtë vijon:

a) veprimet në regjistrë kryhen nga sekretaria e regjistrimit elektronik. Sekretaria e regjistrimit elektronik ka të drejtë leximi, shkrimi dhe modifikimi mbi të dhënat e regjistruara në regjistrë;

b) subjektet e interesuara, të përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 12, të këtij vendimi, kanë të drejtë leximi dhe raportimi mbi të dhënat e regjistruara në regjistrin elektronik;

c) subjektet e interesuara, të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “c”, të pikës 12, të këtij vendimi, kanë të drejtë leximi të të dhënave të regjistrimit elektronik;

ç) subjektet e interesuara, të përcaktuara në shkronjën “ç”, të pikës 12, të këtij vendimi, kanë të drejtë leximi mbi të dhënat e regjistruara në regjistrin elektronik.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

14. Rregulloret për organizimin e funksionimit të brendshëm të regjistrimit elektronik të organizatave jofitimprurëse përcaktohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara sipas nenit



10, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

15. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe organizatat jofitimprurëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 96, datë 9.2.2022

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIMI I PARKIMIT
PUBLIK, LULISHTE E NDRIÇIM”,
BASHKIA CËRRIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i parkimit publik, lulishte e ndriçim”, Bashkia Cërrik.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Cërrik.

3. Pronarët kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “tokë truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë të përgjithshme prej 1 883 925 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e njëzet e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 883 925 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e njëzet e pesë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Cërrik.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Cërrik.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është 3 (tre) muaj nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e përmendur në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Cërrik.

8. Bashkia Cërrik kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Cërrik.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe bën kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Cërrik.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin, kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësive në favor të Bashkisë Cërrik për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Cërrik, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I PARKIMIT PUBLIK, LULISHIT E NDRIÇIM”, BASHKIA ÇËRRIK

NR.	EMËR ATËSI MBIEMËR	ZK	Nr. pas.	Sip. e përgj. truall (m²)	Sip. e prekur truall (m²)	Çmimi për truall	Vlera truall i prekur (lek)	Sip. e gjurmës së objektit, sipas kartelës (m²)	Sip. e përgj. ndërtimi e objektit, sipas kartelës	Sip. shërbimi (m²)	Vlera e sip. prekur, objekt shërbimi me situacion (lek)	Vlera e përgj. truall + objekt (lek)	Konfirmim ASHK Elbasan
1	Tajar Kudret Pëllumbi	1389	2/39/4	135	135	419	56,565	45	45	45	916,292	972,857	Konfirmohet me shkresën nr. 3867/1 prot., datë 8.7.2021, të ASHK Elbasan
2	Sali Ismail Braho	1389	2/93	36	36	419	15,084	36	36	36	529,835	544,919	Konfirmohet me shkresën nr. 3867/1 prot., datë 8.7.2021 të ASHK Elbasan
3	Hajrie Sherif Qevani	1389	2/94-Nd	0	0	0	0	22.7	22.7	22.7	337,615	337,615	Konfirmohet me shkresën nr. 3867/1 prot., datë 8.7.2021 të ASHK Elbasan
	Hajrie Sherif Qevani	1389	2/221	68.1	68.1	419	28,534	0	0	0	0	28,534	Konfirmohet me shkresën nr. 3867/1 prot., datë 8.7.2021 të ASHK Elbasan
VLERA TOTALE PARAPRAKE E SHPRONËSIMIT												1,883,925	



VENDIM
Nr. 98, datë 9.2.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 682, DATË 29.7.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRDORIMIN E FONDEVE PUBLIKE
PËR TRANSPORTIMIN E PUNONJËSVE
ARSIMORË QË PUNOJNË DHE TË
NXËNËSVE QË MËSOJNË JASHTË
VENDBANIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 6, 19 e 28, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të kreut II, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja “a”, e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Punonjësve mësimorë të arsimit parauniversitar, ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social) të institucioneve arsimore publike, që punojnë jashtë qendrave urbane, qytetit/fshatit, larg vendbanimit të përhershëm të tyre, në largësinë mbi 5 (pesë) km deri në 50 (pesëdhjetë) km dhe kthehen brenda ditës në vendbanim.”.

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore miratojnë rrjetin e linjave të transportit, mbështetur në numrin e fëmijëve, nxënësve dhe të punonjësve të arsimit parauniversitar publik, që planifikohen të përfitojnë nga ky shërbim, sipas kriterëve të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, bazuar në informacionin që marrin nga zyrat vendore të

arsimit parauniversitar, brenda muajit tetor për vitin e ardhshëm buxhetor. Listat e përfituesve konfirmohen nga zyrat vendore të arsimit parauniversitar pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për distancën nga vendbanimi i përhershëm dhe dërgohen në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, për të realizuar procedurën e prokurimit publik, brenda muajit nëntor, për vitin e ardhshëm buxhetor.”.

c) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar prokurorjnë me fonde publike shërbimin e transportit të nxënësve dhe të punonjësve arsimorë, sipas rrjetit të linjave të transportit rrethqytetës, të miratuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose qendrore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.”.

ç) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Në rastet kur procedura e prokurimit publik të linjave të transportit, të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, nuk realizohet me sukses nga drejtoria rajonale e arsimit parauniversitar, me autorizimin e kësaj të fundit, zyra vendore e arsimit parauniversitar siguron mbulimin e shpenzimeve për linjat e transportit të nxënësve dhe punonjësve të arsimit parauniversitar publik përfitues, nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë të prindërve të nxënësve, të kujdestarëve ligjorë apo të përfituesve me prokurë të posaçme dhe të punonjësve të arsimit parauniversitar publik përfitues ose nëpërmjet shërbimit postar për ato zona ku shërbimi bankar mungon apo është jo lehtësisht i aksesueshëm, në përputhje me pikën 2, të këtij vendimi, deri në përfundim të vitit buxhetor.

Masa e shpenzimeve për llogaritjet mbi bazën e numrit të ditëve mësimore, numrit të mësuesve, që janë paraqitur në punë, numrit të nxënësve, që kanë ndjekur mësimin, të çmimit të indeksuar me normën e inflacionit të biletës për linjat ndërqytetëse apo rrethqytetëse të transportit, të miratuara me vendimin nr. 146, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar, duke shtuar, vetëm për nxënësit, edhe një bonus prej 50 (pesëdhjetë) % mbi çmimin e indeksuar të biletës, si dhe në bazë të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, duke filluar nga data 1.1.2022.”.

d) Në fund të shkronjës “c”, të pikës 5, shtohen fjalët “... deri në 50 km.”.



dh) Pika 5/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5/1. Zyrat vendore të arsimit parauniversitar e njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë dhe koordinojnë të dhënat për numrin e përfituesve e largësitë nga vendbanimi dhe raportojnë në ministrinë përgjegjëse për arsimin, çdo 3 (tre) muaj.”.

e) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i përvitshëm i ministrisë përgjegjëse për arsimin, e cila transferon fondet përkatëse të zyrat vendore të arsimit parauniversitar, si dhe nga buxheti i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në rastet kur, me vendim të organeve kolegjiale, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të financojnë shpenzime transporti për nxënësit dhe punonjësit e arsimit parauniversitar publik edhe për distanca të tjera, jashtë parashikimeve të këtij vendimi.”.

2. Në rast se nuk ekziston një kontratë e lidhur në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, deri në lidhjen e kontratës së parë të transportit përkatës, shpenzimet e transportit u mbulohen drejtpërdrejt nxënësve dhe punonjësve arsimorë përfitues.

3. Në rastet kur procedura e prokurimit publik është e pasuksesshme apo pavarësisht se kontrata fillestare, e lidhur me një operator ekonomik, mund edhe të jetë zgjatur sipas ligjit për prokurimin publik, por, përsëri, autoriteti kontraktor është në pamundësi për të pasur një marrëdhënie kontraktore në përputhje me parashikimet e këtij ligji, edhe në këto raste shpenzimet e transportit u mbulohen drejtpërdrejt nxënësve dhe punonjësve arsimorë përfitues.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 99, datë 9.2.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 146, DATË 10.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E MUZEUT TË ARSIMIT KORÇË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 214, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të kreut IV, të vendimit nr. 146, datë 10.3.2021, të Këshillit të Ministrave, data “... 1.1.2022, ...” zëvendësohet me “...1.1.2023...”.

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Muzeu i Arsimit Korçë dhe Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 1052 (5883), datë 21.12.2021, vendosi heqjen e zëotësisë për të vepruar të shtetases Besjana Hasan Zeneli, e datëlindjes 3.5.1996, në Bulçar, Gramsh, me numër personal J65503019T, dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë ligjore të Shoqatës Shqiptare Misionarët e Bamirësisë “Motrat Nënë Tereza”, me seli në qytetin e Shkodrës.

KËRKESË

Shtetasi Dahri Mustafaj, lindur dhe banues në fshatin Gramsh, të rrethit Lushnjë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë shpalljen të vdekur të shtetases Alma Mustafaj, e lindur më 3.5.1991, në Lushnjë.

KËRKUES
Dahri Mustafaj

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë